



ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS (OFK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr.04/L-150, nenit 20, paragrafi 1 të Statutit të Odës së Farmacistëve të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 26/06/2021, nxjerr këtë :



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 320 Dt 07/07/21

V E N D I M

- I. Për plotësim-ndryshimin e rregullorës nr. 84 të viti 2019 për përcaktimin e llojit të shkeljeve etike dhe procedurat e mbikqyrjes etike dhe profesionale si më poshtë :
 - a. Paragrafi 2, i nenit 10 riformulohet si në vijim „Në qoftë se shkeljet disiplinore të lehta përsëriten në periudhen më të afërt se 12 muaj, konsiderohet se është shkatuar shkelje e rëndë e kodit të etikës „
 - b. Pas paragrafi 4 të nenit 33 shtohet paragraf i ri me këtë përmbajtje „Procedura e përcaktuar në këtë nen dhe nenin 34 zbatohet përshtatshmërisht edhe në rastet kur Këshilli Etik ex-officio fillon procedurën hetimore”
 - c. Pas nenit 81, shënohet paragrafi 81 x me këtë përmbajtje
„Neni 81 X

Rehabilitimi nga masa disiplinore

- I. Masa disiplinore e shqiptuar ndaj anetarit, fshihet nga regjistri i masave disiplinore pas skadimit të periudhave kohore vijuese, nëse anëtari brenda afateve vijuese nuk kryen shkelje tjetër etike :

- 1.1 Një (1)vite nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit të plotfuqishëm me të cilin është konstatuar shkelje e lehtë e kodit etik dhe është shqiptuar masa disiplinore





1.2 Tri (3) vite nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit të plotfuqishëm me të cilin është konstatuar shkelje e rëndë e kodit etik dhe është shqiptuar masa disiplinore

1.2.1 Përfundimisht nga ky paragraph, masa disiplinore e tërheqjes së përkohshme të licencës apo fshirjes nga regjistri i anëtarësisë me të paktën 4 vite apo tërheqja e përhershme e licencës nuk fshihen nga regjistri i masave disiplinore.”

- II. Udhëzohet Shërbimi Profesional për inkuadrimin e këtij vendimi në kuadër të rregullorës 84 të vitit 2019.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

P'dërgohet

- **Shërbimit Profesional**
- **Këshillit Etik**

Kryetari i OFK-së

Dr.sc. Arianit Jakupi

